



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
SENATI AKADEMIK

Nr. 689/14 prot.

Elbasan, më 17.....03.2025

VENDIM

Nr. 42 datë, 17 /03 /2025

"Mbi miratimin e kuotave të pranimit, në programet e studimit të ciklit të dytë të studimeve , për vitin akademik 2025-2026"

Bazuar në Ligjin 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 3, neni 25, pika 7; neni 37, pikat 1 dhe 2, neni 38, pika 1, dhe pika 3, në VKM nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë", i ndryshuar, pika 2.7, germa a,b,c, në Statutin e UE-së "A. Xhuvani" neni 9, germa h, si dhe në propozimet e njësive kryesore të UE, Senati Akademik në mbledhjen e datës 17.03.2025

V E N D O S I :

1. Të miratojë kuotat e pranimit në Universitetin e Elbasanit "A. Xhuvani" për vitin akademik 2025-2026, në programet e studimit ciklit të dytë të studimeve "Master profesional", me kohë të plotë (tabela 2 bashkëlidhur), gjithsej **799 kuota** të ndarë si më poshtë vijon:
 - a) Kuotat e pranimit për kandidatë studentë brenda vendit: **699 kuota**.
 - b) Kuota e pranimit për kandidatë studentë nga trojet: **21 kuota**.
 - c) Kuotat e pranimeve për kandidatët studentë që aplikojnë për transferim studimesh: **5 kuota**
 - d) Kuotat e pranimit për kandidatët studentë që aplikojnë për një program të dytë studimi: **74 kuota**.
2. Të miratojë kuotat e pranimit në Universitetin e Elbasanit "A. Xhuvani" për vitin akademik 2025-2026, në programet e studimit ciklit të dytë të studimeve "Master i shkencave", me kohë të plotë (tabela 3 bashkëlidhur), gjithsej **894 kuota** si më poshtë vijon:
 - a) Kuotat e pranimit për kandidatë studentë brenda vendit: **748 kuota**.
 - b) Kuota e pranimit për kandidatë studentë nga trojet: **19 kuota**.
 - c) Kuotat e pranimeve për kandidatët studentë që aplikojnë për transferim studimesh: **14 kuota**

d) Kuotat e pranimit për kandidatët studentë që aplikojnë për një program të dytë studimi: **113 kuota.**

3. Kuotat e parealizuara të pikave 1/b; 1/c; 1/d; 1/e; dhe të pikave 2/b, 2/c, 2d ,2/e, do të shpërndahen nga Rektorati sipas kërkesave të njësive kryesore të UE-së.
4. Ky vendim i përcillet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Qendrës së Shërbimeve Arsimore.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

